



e Rahovecit

Rahoveci dhe Xagħra e Maltës zyrtarizojnë binjakëzimin

Komuna e Rahovecit dhe Këshilli Lokal i Xagħra-s në ishullin Gozo të Maltës kanë nënshkruar marrëveshjen e binjakëzimit, duke hapur rrugën për bashkëpunim në shkëmbimin e përvojave, promovimin e vlerave kulturore dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta në kuadër të programeve të Bashkimit Evropian. Binjakëzimi lidhet edhe me projektin e BE-së “Golden Years, Active Voices: Empowering Elderly Citizens in Democratic Life”, ku Xagħra është lider i projektit, ndërsa Rahoveci partner. Projekti synon fuqizimin e rolit të qytetarëve të moshuar dhe nxitjen e dialogut ndërbrezor. Gjatë vizitës, delegacioni i Rahovecit mori pjesë edhe në Festivalin Tradicional të Fikut, një aktivitet që promovon kulturën dhe traditat e Xagħra-s.



Rahoveci nderon luftëtarët me Medaljen e Lirisë

Në prag të 27-vjetorit të çlirimit të Rahovecit me rrethinë, në amfiteatrin e Kompleksit Përkujtimor të Dëshmorëve të Kombit në Gradish, u nda cikli i parë i Medaljeve të Lirisë për veteranë dhe veprimtarë që kontribuan në luftën për çlirimin e vendit. Gjatë ceremonisë u theksua se medaljet përfaqësojnë një mirënjohje institucionale për sakrificën e luftëtarëve të lirisë dhe një kujtesë për brezat e rinj.



Dekorata «Ukshin Hoti», i jepet Adem Demaçit – pas vdekjes

Në shënim të 83-vjetorit të lindjes së profesorit Ukshin Hoti, Komuna e Rahovecit i ka ndarë pas vdekjes veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi, Dekoraten komunale **“Ukshin Hoti”**.

Gjatë ceremonisë u vlerësua kontributi i Demaçit për lirinë dhe të drejtat e shqiptarëve, duke e cilësuar atë, së bashku me Ukshin Hotin, si një ndër figurat më të rëndësishme të qëndresës kombëtare. Dekorata u pranua nga Shefik Sadiku, kryetar i Shoqatës së ish - të Burgosurve Politikë të Kosovës, në mungesë të familjarëve të Adem Demaçit.



Komuna e Rahovecit mban takim publik për punën gjashtëmujore të vitit 2026

Komuna e Rahovecit ka mbajtur takimin e parë publik për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, ku u prezantua raporti i punës së Zyrës së Kryetarit dhe të gjitha drejtorive komunale, si dhe ecuria e projekteve dhe aktiviteteve të realizuara gjatë kësaj periudhe.

Sipas komunës, transparenca dhe llogaridhënia mbeten parime kryesore të qeverisjes lokale.

